



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KUVENDI

Komisioni për Ekonominë dhe Financat

Tiranë, më 19.11.2018

Dokument parlamentar

RAPORT

PËR PROJEKTLIGJIN “PËR RATIFIKIMIN E MARRËVESHJES NDRYSHUESE NR.1 TË MARRËVESHJES SË HUAS TË DATËS 31.12.2012, NDËRMJET REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË DHE BANKËS EVROPIANE PËR RINDËRTIM DHE ZHVILLIM (EBRD), PËR FINANCIMIN E PROJEKTIT TË PËRMIRËSIMIT TË SIGURISË SË DIGËS NË HIDROCENTRALIN E KOMANIT, RATIFIKUAR ME LIGJIN NR.103/2013”

Komisioni për Ekonominë dhe Financat, në cilësinë e komisionit përgjegjës, në mbledhjen e datës 19 nëntor, shqyrtoi projektligjin “Për ratifikimin e marrëveshjes ndryshuese nr.1 të marrëveshjes së huas të datës 31.12.2012, ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe Bankës Evropiane për Rindërtim dhe Zhvillim (EBRD), për financimin e projektit të përmirësimit të sigurisë së digës në hidrocentralin e Komanit, ratifikuar me ligjin nr.103/2013”, i cili është propozuar nga Këshilli i Ministrave në përputhje me nenet 78, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, nenit 68, të Rregullores së Kuvendit dhe nenit 17, të ligjit nr.43/2016, datë 21.4.2016, “Për marrëveshjet ndërkombëtare në Republikën e Shqipërisë”.

Të pranishëm në mbledhjen e Komisionit për të prezantuar projektligjin dhe për t’u dhënë shpjegime pyetjeve të deputetëve, ishin zëvendësministrija e Infrastrukturës dhe Energjisë znj Cinari dhe zëvendësministri i Financave dhe Ekonomisë z. Luçi.

Projektligji i miratuar në parim me vendimin e Këshilli të Ministrave nr. 677, datë 14.11.2018, ka për qëllim miratimin e disa ndryshimeve në marrëveshjen e huasë së dhënë nga BERZH për financimin e projektit të përmirësimit të sigurisë së digës në hidrocentralin e Komanit, i cili ka hyrë në fuqi në prill të vitit 2013.

Sipas marrëveshjes bazë të huasë të ratifikuar me ligjin nr.103/2013, Banka Evropiane për Rindërtim dhe Zhvillim anagazhoj të akordonte huanë prej 12,700,000 euro, për të ndihmuar financimin e projektit “Për përmirësimin e sigurisë së digës në hidrocentralin e Komanit” dhe konkretisht programeve të investimeve për fuqizimin e masave për mbrojtjen nga shkëmbinjtë dhe rregullimin e shtratit të rrjedhës dhe zonën e gërryerjes së digës. Në marrëveshje projekti pritej të përfundonte brenda datës 31 dhjetor 2015, ndërsa disbursimi i fondeve do të ishte i mundur të bëhej deri më datën 31 dhjetor 2016. Punimet civile do të bashkëfinancoheshin nga Banka Botërore, Bashkëpunimi Zvicerian

(SECO) dhe KfW-ja, ndërsa shërbimet e konsulencës për mbikqyrjen e projektit do të financoheshin nga Banka Botërore.

Projektligji që po shqyrtojmë sot kërkon miratimin e marrëveshjes ndryshuese nr.1 që mundëson përdorimin e shumës së kursyer nga përfundimi i projektit që arrin në 6,128,224 euro si dhe zgjerimin e programeve të investimeve në mënyrë që të përfshihen edhe rehabilitimi i portave të shkarkimit të hidrocentralit të Komanit. Konkretisht marrëveshja ndryshuese përmban amendimet e mëposhtme:

- Rishikimin e pjesës A të projektit për përforcimin jo vetëm të zonës së grykës së digës por edhe të zonës në depozitimin e majtë si dhe reduktimin e shumës së alokuar për këtë pjesë nga 10 milion euro në rreth 5,620,000 euro.
- Reduktimin e shumës së alokuar të huasë për pjesën B: Fuqizimi i masave për mbrojtjen nga rënja e shkëmbinjve nga 2,573,000 euro që ishte parashikuar në 2013 në rreth 825,201 euro.
- Propozimin e një programi investimi të ri për rehabilitimin e portave të shkarkimit të hidrocentralit, i cili parashikohet të financohet në masën 6,128,224 euro.
- Zgjatjen e afatit të disponueshmërisë së fondeve nga data 31 dhjetor 2016 në 31 dhjetor 2021.
- Zëvendësimin e emërtimeve “Ministria/ Ministri e/i Financave” me “Ministria/ Ministri e/i Financave dhe Ekonomisë”, si dhe reflektimin e ndryshimit të adresës së huamarrësit.

Për këtë arsye shtesa e kontratës që Qeveria na ka paraqitur përmban 6 nene dhe 2 shtojca.

Gjatë shqyrtimit u vlerësua nevoja urgjente për hyrjen në fuqi menjëherë të këtij ligji, me qëllim fillimin e menjëhershëm të financimit për përforcimin e zonës së grykës së digës, fuqizimin e masave mbrojtëse si dhe rehabilitimin e portave të shkarkimit, brenda afateve, prandaj Komisioni miratoi ndryshimin e nenit 2, si më poshtë:

“Neni 2

Ky ligj hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në “Fletoren Zyrtare’.”

Në përfundim të diskutimeve, duke pasur parasysh që funksionimi i sigurtë dhe i besueshëm i hidrocentralit të Komanit si një nga hidrocentralet më të mëdhenj në vend, nuk është vetëm çështje sigurie, por përbën gjithashtu edhe një burim potencial të menaxhimit të të ardhurave për qeverinë në të ardhmen, Komisioni e miratoi projektligjin me votat pro të të gjithë anëtarëve të pranishëm në mbledhje.

RELATOR

KRYETAR

Arben PËLLUMBI

Erjon BRAÇE